



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Universiteti AAB SH.P.K.

Numri Unik Identifikues: 810478299

Personi i autorizuar: Ilir Tafa

OSHMA: AAB Radio

Adresa: Zona Industriale, Prishtinë



VENDIM

për ndryshimin e emrit të AAB Radio në A Radio - me seli në Komunën e Prishtinës

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. AAB Radio është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio (Radio), me mbulim regional, i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të programeve, në gjuhën shqipe dhe me seli në komunën e Prishtinës. AAB Radio është pajisur me licencë të KPM-së me datën 24 dhjetor 2019, me afat të licencës prej shtatë (7) vitesh ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për KPM-në.
3. Me datën 2 prill 2021, AAB Radio ka dorëzuar një kërkesë në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit të AAB Radio në A Radio.

Arsyetim

4. Në pajtim me Nenin 21, paragrafin 7 të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2017/02), logo/emri i një OSHMA mund të ndryshohet vetëm pas miratimit nga KPM. Pargrafi në fjalë përcakton: *“I licencuari duhet ta identifikojë përmabjtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraparë nga KPM-ja.”*
5. Komisioni konstaton se KPM nuk ka asnjë të licencuar me emër të njëjtë apo të ngjajshëm me emrin e propozuar për ndryshim A Radio, prandaj ndryshimi i emrit të AAB Radio në

A Radio nuk do të paraqet pengesa apo konfuzion tek dëgjuesit gjatë transmetimit të programeve të radios.

6. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Rekomandim

7. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 16 prill 2021, që të marrë vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e emrit të AAB Radio në **A RADIO**.

8. Komisioni rekomandon që, përveç ndryshimit të emrit nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës.

9. Këtë rekomandim e propozon Komisioni e Komisionit të Pavarur të Mediave.


Luan LATIFI

Kryeshef Ekzekutiv
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.04.2021

datë